



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**QENDRA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË**  
**KRYETARI**

---

**URDHËR**

Nr 371 datë 08.07. 2019

**“PËR NGRITJEN E BORDIT KËSHILLIMOR PRANË KRYETARIT TË  
QENDRËS KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË”**

Në zbatim të nenit 5, pikat 2 dhe 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 602, datë 21.08.2003, “Statuti i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë”, në vijim të marrëveshjes së arritur në takimin e përfaqësuesve të disa shoqatave të kineastëve, si dhe Kryetarit të QKK-së, nr. 362 Prot., datë 04.07.2019;

**URDHËROJ:**

1. Të krijohet Bordi Këshillimor pranë Kryetarit të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, i përbërë nga:
  - Përfaqësues i Shoqatës së Krijuesve të Animacionit Shqiptar “Albanimation”;
  - Përfaqësuesi i Shoqatës “Lumiere”;
  - Përfaqësuesi i Shoqatës së Kineastëve të Rinj “Belmond”;
  - Përfaqësuesi i Shoqatës “Albanian Producers and Filmmakers Association”;
  - Përfaqësuesi i Shoqatës “Lidhja e Kineastëve të Filmit Dokumentar”;
  - Përfaqësuesi i Shoqatës “Universal Film Albania”;
  - Përfaqësuesi i Shoqatës “Shoqata e Kineastëve Shqiptarë”;
  - Përfaqësuesi i Shoqatës “Albanian Woman in Audiovisual”.
2. Kryetari i QKK-së do të mbledhë Bordin Këshillimor të paktën një herë në muaj.
3. Kryetari i QKK-së do të përcaktojë rendin e ditës, në konsultim paraprak me përfaqësuesit e shoqatave.
4. Kryetari i QKK-së do të diskutojë dhe marrë sugjerime, për çështje të ndryshme të karakterit organizativ, juridik dhe artistik, në funksion të rritjes së cilësisë në prodhimet e kinematografisë shqiptare.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

